



REPUBLIKA E SHQIPËRIE



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 173 / Prot

Shkodër me 17.03, 2025

V E N D I M

Nr. 04, Datë 13.03.2025

“PËR SHITESË PLANI NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2025, NË KUADËR TË FONDIT SOCIAL”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 13.03.2025, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Për shtesë plani në Buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025, në kuadër të fondit social”, bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 97/2023 “Per Buxhetin e Vitit 2024”, pikat 1, 2/b të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, shkresa nr.5245/7, datë 30.12.2024 “Njoftim” dhe shkresa 209/1 datë 20.01.2025 “Transferim fondesh në ofrimin e shërbimit e përkujdesjit në nivel qarku dhe bashkie” të MSHMS, Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **12 Vota Pro, 0 Vota Kunder** dhe **0 Vota Abstenim**,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025, Transfertë e Kushtëzuar nga MSHMS, për financimin në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror rezidencial për persona me aftësi të kufizuara në shumën totale **22,694,816 lekë** dhe përkatësisht;
 - a. Financim për Shtëpi-Familje Madonnina della Grappa” për vitin 2025 në programin 10430 , Art 6060000, shpenzime korente, shumën **5,552,317 lekë**.
 - b. Financim për Qendrën Ditore “Buzëqeshja e Motër Lezes” ofruar nga Shtëpi-

Familje Madonnina della Grappa” për vitin 2024 në programin 10430 , Art 6060000, shpenzime korente, shumën **8,156,412 lekë**.

Financim për Shtëpi-Familje ‘shtëpia Rregullatore e Bashkësisë Misionarët e Dashurisë Kontemplative” për vitin 2024 në programin 10430 , Art 6060000, shpenzime korente, shumën **8,986,087 lekë**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder .
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

